



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-407/2013
Br. Prot. 01-407/2013
Date 14.02.2013
Datum 14.02.2013

DATË/A:	14.02.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Fadil Abazi Menaxher i Zyrës Prokurimit në Komunën e Vitisë
CC:	z. Nexhmedin Arifi Kryetar i Komunës së Vitisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Mbikëqyrja Profesionale e Projekteve Kapitale - Ritender"

Të nderuar

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Mbikëqyrja Profesionale e Projekteve Kapitale -Ritender " me nr. prokurimit : VI657-13-002-221 ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Mbikëqyrja Profesionale e Projekteve Kapitale - Ritender " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 - L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Njësia e Kërkesës e A.K e cila përgatit kërkesën për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit para se të inicioj procedurën e prokurimit duhet të përgatit një paramasë dhe paralogari ku duhet të specifikohen të gjithë projektet të cilët do të mbikëqyren gjatë kohëzgjatjes së kontratës, për aktivitetin e prokurimit në fjalë me të cilën Zyra e Prokurimit me rastin përgatitjes së dosjes së tenderit, të ketë mundësi që paramasën e sasive ta vendos në Dosje të tenderit në mënyrë që Operatorët Ekonomik të ketë një pasqyrë sa më reale për ofertim sa më transparente, me këtë rast A.K ka dështuar ti përmbahet nenit 9 të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Zyra e prokurimit në Komunën e Vitisë, si autoritet kontraktues, në njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit – Ritender “Shërbime” të procedurës së hapur me nr. prokurimi VI657-13-002-221 dhe titulli i tenderit “ Mbikëqyrja Profesionale e Projekteve Kapitale - Ritender” në Pjesën, Aneksi 6 Kriteret e dhënies Kontratës – Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm ka kërkuar si kriter i dhënies të jetë Stafi Profesional dhe Përvoja i cili është përfshirë në këto tri pika:

a) Stafi profesional dhe Përvoja

1. Dy (2) Inxh.dipl të Arkitekturës me minimum 3 vjetë përvojë pune.
 2. Një (1) Inxh. dipl të Ndërtimtarisë me minimum 3 vite përvojë pune.
 3. Një (1) Inxh. dipl të Ndërtimtarisë - konstruktiv me minimum 3 vite përvojë pune.
 4. Një (1) Inxh. dipl të Ndërtimtarisë - hidroteknik me minimum 3 vite përvojë pune.
 5. Një (1) Inxh. dipl të Elektroteknikës - me minimum 1 vitë përvojë pune
 6. Një (1) Inxh. dipl të Makinerisë me minimum 1 vitë përvojë pune
 7. Një (1) Inxh. dipl të Gjeodezisë me minimum 1 vitë përvojë pune
- b. Menaxheri i projektit të jetë inxhinierë i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës me përvojë minimum pesë (5) vite.

Për kriteret e paraqitura te pikat a) 1 - 7 dhe b , Autoriteti Kontraktues ka kërkuar këto dëshmi:

1. Diplomat përkatëse – kopje notorizuara
 2. Lista e stafit në marrëdhënie të rregullte pune të evidentuar në ATK-ë për vitin 2012 ose së paku për TM4-2012.
 3. Përvoja e dëshmuar me kontrata pune ose CV
- c. Një deklaratë (listë) të mjeteve apo pajisjeve adekuate për realizimin e këtyre shërbimeve që konkurroni.

Për të gjitha këto pika të kriterëve për dhënie të kontratës pesha tyre e poentimit është 30 %.

Autoriteti kontraktues me rastin e përgatitjes së Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në web faqen e KRPP-së duhet të ketë kujdes për të siguruar që kriteret e përzgjedhjes të mos përdoren si kriterë për dhënien e kontratës.

A.K duhet të përdor si kritere për dhënie të kontratës vetëm kriteret të cilat janë të lidhura direkt me lëndën e kontratës dhe kritere të cilat duhet të kenë peshë të caktuar.

Në bazë të nenit 69 LPP-së kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë të publikuar në web faqen e KRPP-së të cilat A.K i ka përcaktuar si kritere të matjes me peshë të caktuar - Stafi Profesional dhe Lista e mjeteve apo pajisjeve adekuate për realizimin e këtyre shërbimeve, duhet të jenë të përcaktuara si kritere minimale për kualifikim të cilat duhet ti përmbush O.E për tu konsideruar i kualifikuar, sipas nenit 23.5 Udhëzuesit Operativ, Kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kritere në procesin e dhënies së kontratës, nuk mund të kenë as peshë të caktuar ato janë vetëm kërkesa të kualifikimit, Autoriteti Kontraktues me këtë rast nuk ka respektuar nenin 52.3 ligjit Prokurimit Publik 04/L-052 dhe nenin 25.10 Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik .

Autoriteti Kontraktues me rastin e përgatitjes së Dosjes së tenderit të Seksioni II fleta e të Dhënave të tenderit (FDT) të Kërkesat mbi Gjendjen Ekonomik dhe Financiar pika 8.1 ka kërkuar : që O.E të ketë (Së paku (3) tri kontrata Publike me Organizatat Buxhetore në lëmin e Mbikëqyrjes në tri vitet e Fundit), kjo është në kundërshtime me nenin 69 pika 4.2 Ligjit Prokurimit Publik 04/L-042.

Në faqe 42 pjesa II Lista e çmimeve të përshkrimi (Mbikëqyrja e realizimit të të gjithë projekteve investive në Komunën e Vitisë për vlerat investive të projekteve $\geq 1,000.00$ €) ka kërkuar nga O.E të ofertojnë me (%) dhe duke dhënë numrin e poenëve 40, nuk është qartësuar sipas Ligjit të Prokurimit Publik .

Me respekt!